



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.13

Nëntor 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

**I. Mbledhje e Këshillit të
Ministrave e datës
22.10.2004**

PROJEKTLIGJE

**(Vendime për propozime
projektligjesh)**

1. "Për Sportin"

- Ky ligj synon mbrojtjen dhe garantimin e shtetasve që merren me edukimin fizik, përcaktimin e kompetencave të autoriteteve qendrore dhe vendore, mbështetjen financiare dhe organizative për funksionimin e institucioneve dhe organizatave sportive, duke vendosur rregulla të funksionimit dhe organizimit të sportit. Në projektligj është përcaktuar gjithashtu statusi i Këshillit Kombëtar të Sportit, si një organ konsultativ pranë ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Janë vendosur rregulla lidhur me kontrollin mjekësor dhe antidopingut si dhe janë përcaktuar të drejtat

(Vijon në faqen 2)

Nga Punimet e Kuvendit

1. Projektligji "Për Buxhetin faktik të Shtetit të vitit 2003" dhe Raporti I Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2003 (miratuar në seance plenare më 14 tetor 2004)

Raporti i Këshillit të Ministrave dhe Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit për buxhetin faktik të vitit 2003 pasqyrojnë në mënyrë të hollësishme të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me realizimin e Buxhetit të Shtetit të këtij viti. Në Raportin e Këshillit të Ministrave analizohet realizimi i treguesve kryesorë makroekonomikë gjatë vitit 2003 dhe arrihet në përfundimin se ekonomia shqiptare, në krahasim me një vit më parë, ka arritur rritje në të gjithë këta tregues. Objektivat e përcaktuara në ligjin "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003" për treguesit e rritjes ekonomike, rritjes së të

(Vijon në faqen 4)

**Në këtë numër
do të lexoni:**

**1. Nga Mbledhjet e
Këshillit të Ministrave
faqe 1-3**

**2. Informacion mbi faqet
e internetit të
Institucioneve Qendrore
faqe 1**

**4. Nga punimet e
Kuvendit për periudhën
1-15 tetor 2004
faqe 1,4**

**5. Kalendari 2 javor i
Kuvendit,
1-12 nëntor 2004
faqe 5-7**

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qendrore

Kuvendi i Shqipërisë
www.parlament.al

Këshilli i Ministrave
www.keshilliministrave.al

Presidenca
www.president.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

Ministria e Arsimit dhe e
Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme
www.mfa.gov.al

Ministria e Shëndetësisë
www.moh.gov.al

Ministria e Rendit Publik
www.mpo.gov.al

Ministria e Pushtetit Vendor
dhe Decentralizimit
www.mpvd.gov.al

Ministria e Transportit dhe
Telekomunikacionit
www.mtt.gov.al

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

dhe detyrimet e individit në sport etj.

2. Për dërgimin e një kompanie paqëruajtëse shqiptare në Bosnje-Hercegovinë për të marrë pjesë në operacionin "ALTHEA" të Bashkimit Europian.

3. Për ratifikimin e marrëveshjes grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

VENDIME të Këshillit të Ministrave

1. Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet, që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike.

2. Miratimi i rregullave teknike për përcaktimin e betoneve strukturore.

- Këto rregulla teknike kanë të bëjnë me përdorimin e betoneve strukturore, dhe janë një akt i cili për afron më tej me standardet europiane. Ai mbështetet gjithashtu në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

3. Për shpalljen e sistemit Ligatinor, Vjosë-Nartë, Peisazh Ujor-Tokësor i mbrojtur.

4. Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 12.01.2004 "Për dhënie ndihme financiare familjeve të viktimave të mbytura në ujërat e Detit Jon në datën 10.01.2004".

5. Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.601, datë 2.11.2001 "Për funksionet në Ministrinë e Rendit Publik, që kanë të drejtën e mbajtjes së gradës së Policisë së Shtetit.

6. Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Paradhënies së Kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për përgatitjen e projektit "Për menaxhimin e integruar dhe pastrimin e zonës bregdetare".

7. Për miratimin në parim të Protokollit nr.14, të Konventës "Për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore" që ndryshon sistemin e kontrollit të Konventës.

- Protokollin nr.14 është miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës më datë 12.05.2004 dhe ka për qëllim ruajtjen e efikasitetit të kontrollit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

8. Për miratimin në parim të Traktatit të Miqësisë dhe të Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës.

9. Për miratimin e kryetarit dhe të antarëve të Këshillit të Autoritetit të Mbikqyrjes së Sigurimeve.

10. Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për programin e fazës së tretë të kredisë, në mbështetje të uljes së varfërisë.

11. Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë, për mbështetjen e Projektit të Shërbimeve Eficente të Punësimit në Shqipëri.

12. Për lejimin e Ministrisë të Rendit Publik të përdorë fonde buxhetore për blerje autoveturash, në përjashtim me

vendimin nr.490, datë 23.07.2004 të Këshillit të Ministrave "Për kufizimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2004".

13. Për heqjen e kufizimeve të shpenzimeve për investime për Ministrinë e Financave për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të parave, dhe Kryeministrinë.

14. Për veprimtarinë e Jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike.

15. Për emërime dhe lirime në detyrë.

VENDIME të Këshillit të Ministrave (Mbledhja e Datës 24.10.2004)

1. Miratimin në parim të projekt marrëveshjes së koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Aeroport Partners (TAP) sh.p.k., si dhe të projekt marrëveshjes mbështetëse të ortakëve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Hochtief Airoport Gmbh, Fondit Shpitaro-Amerikan për Ndërmarrjet dhe Tirana Airoport Partners (TAP), sh.p.k.

II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 29. Tetor. 2004

PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore" të ndryshuar.

(Vijon në faqen 3)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

- Ndryshim në ligjin e lartpërmendur bëhet për të ndrequr të metat që janë vënë re deri tani nga licensimi i pakontrolluar, në raportin e autoveturave taksi me 4+1 dhe 8+1, për t'u dhënë mundësi furgonave të lëvizin edhe në linjat e rregullta rrethqytetëse. Gjithashtu ndryshime bëhen edhe në kompetencat e organeve përkatëse lidhur me përcaktimin e numrit maksimal të taksive sipas qarqeve, duke synuar gjithashtu edhe një decentralizim të mëtejshëm dhe dhënie kompetencash pushtetit vendor.

2. "Për ratifikimin e Konventës nr. 97 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)" Mbi migracionin për punësim

- Konventa e ILO-s nr 97, me tre anekset dhe Rekomandimin nr. 86, përbën bazën e instrumentave ndërkombëtare për mbrojtjen e punëtorëve migrantë nga diskriminimi dhe shfrytëzimi në vendet e punësimit.

Ratifikimi i Konventës përbush edhe një nga rekomandimet e Komisionit Europian, ILO dhe IOM, për trainimin e dukurisë migratore në përputhje me standartet ndërkombëtare.

3. Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për vendosjen e linjës ndërkombëtare liqenore për udhëtarët Shkodër- Vispazar."

-Marrëveshja synon rritjen e bashkëpunimit në fushën e transportit në liqenin e Shkodrës, duke krijuar më shumë mundësi për lëvizjen e lirë të njërëzve. Kjo do të bëhet ndërmjet veprimit të linjave të

rregullta liqenore në shërbim të udhëtarëve, duke zhvilluar dhe bashkëpunimin në fushën e turizmit.

4. Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së republikës së Polonisë për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar.

5. Për pyjet dhe shërbimin pyjor.

- Projektligji paraqet një sintezë të të drejtave dhe detyrimeve kryesore në fushën e mbrojtjes e të qeverisjes së fondit pyjor kombëtar dhe të mjedisit pyjor për të gjithë palët e interesuara, shtetin me strukturat e veta qendrore e lokale, personat juridikë e fizikë, privatë e shtetërorë dhe publiku i gjerë. Gjithashtu përmirësime ligjore ka edhe për parandalimin e dëmtimeve në rritjen e kontrollit kudo.

VENDIME të Këshillit të Ministrave

1. Për miratimin në parim të Konventës nr.168 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, "Për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen nga papunësia."

2. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Moldavisë, për bashkëpunim në fushën sanitaro-veterinare.

3. Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të hidrocentraleve vendore.

4. Për kategorizimin e bibliotekave.

- Në zbatim të kritereve të përcaktuara në ligjin "Për bibliotekat", sipas këtij venimi bibliotekat publike janë kategorizuar në varësi të koleksioneve, numrit të përdoruesve si

dhe të shërbimeve të tjera bibliotekare që ata kryejnë.

5.Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 27.8.2004 "Për miratimin e kuotës së pranimit të studentëve në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari" për vitin 2004-2005.

6. Për miratimin e shpenzimeve operative për vitin 2005 të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të largimit e përpunimit të ujrave të ndotura.

7. Për lejimin e Ministrisë të Ekonomisë të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për prokurimin e fondëve për arbitrazhin me shoqërinë konsulente IMI, për tarifën e suksesit në procesin e privatizimit të shoqërisë anonime AMC.

8. Për dhënie mendimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8685, datë 9.11.200 "Për një trajtim të vecantë punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë"

9. Për dhënie mendimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8685, datë 9.11.200 "Për një trajtim të vecantë financiar të detarëve në pension, që kanë punuar në nëndetëse."

10. Për listën e personave të shpallen si financues të terrorizmit.

11. Për lejimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për prokurimin e fondeve që financojnë shpenzimet e festimeve të 60 vjetorit të clirimit të Atdheut.

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-15 TETOR 2004

(Vijon nga faqja 1)

ardhurave, uljes së defiçitit buxhetor dhe nivelit të inflacionit, sipas Raportit, janë realizuar. Në Raport paraqitet një analizë e hollësishme e të ardhurave dhe shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit, e defiçitit buxhetor dhe e financimit të tij, si dhe jepet një tablo e hollësishme e borxhit publik dhe e menaxhimit të tij.

Në Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit pasqyrohen mendime rreth Raportit të Këshillit të Ministrave për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2003. Pas analizës së hollësishme që i bëhet realizimit të të ardhurave e shpenzimeve buxhetore, defiçitit buxhetor dhe financimit të tij, borxhit shtetëror dhe financimit të tij etj, arrihet në përfundimin se ka përputhje midis realizimit të këtyre treguesve dhe raportimit të tyre. Në Raport jepen rekomandime për masat që duhet të marrë Qeveria për rritjen e të ardhurave buxhetore dhe të efektivitetit të përdorimit të shpenzimeve buxhetore. Në vijim, Raporti pasqyron rezultatet e kontrollit të ushtruar në organet dhe institucionet shtetërore, duke vënë në dukje edhe disa difekte në punën e këtyre institucioneve dhe duke rekomanduar masat për përmirësimin e tyre.

Gjatë diskutimit të zhvilluar në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit si dhe në seance plenare deputetët e majorancës u shprehën dakord me të dy raportet. Ata vlerësuan pozitivisht punën e Qeverisë për realizimin e objektivave të parashikuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik e Social të vendit dhe në ligjin "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003". Përfaqësuesit e Qeverisë vlerësuan punën e bërë në drejtim të konsolidimit të qëndrueshmërisë makroekonomike, mbajtjes së inflacionit në nivelet e parashikuara nga Banka e Shqipërisë, uljes së defiçitit buxhetor, uljes së borxhit publik, përmirësimit të procesit të hartimit, miratimit dhe realizimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social dhe harmonizimit më të mirë të prioriteteve të saj me buxhetin afatmesëm dhe me buxhetet vjetore, thellimit të procesit të decentralizimit, zhvillimeve pozitive në sistemin bankar dhe rritjes së kreditimit të biznesit privat. Ata vlerësuan rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit si shumë të rëndësishme për përmirësimin e punës së ekzekutivit në zbatim të legjislacionit, të cilat do të mbahen parasysht edhe gjatë hartimit të projektbuxhetit të vitit 2005.

Duke qenë se shpenzimet e Buxhetit të Shtetit janë realizuar në përputhje me ligjin "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit", të konfirmuara edhe nga Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ata u shprehën dakord me projektligjin.

Deputetët përfaqësues të opozitës u shprehën kundër miratimit të projektligjit, duke vënë në dukje tendencën në rënie të nivelit të të ardhurave dhe shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në raport me PBB-në nga viti 2001 në vitin 2003 dhe nivelin e ulët të tyre në raport me vendet e tjera të rajonit, keqadministrimin e të ardhurave dhe përkeqësimin e strukturës së shpenzimeve, duke rritur shpenzimet korrente dhe duke ulur shpenzimet për investime publike, rritjen e varfërisë dhe të nivelit të papunësisë, shpërndarjen territoriale të shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në disfavor të zonave të varfra dhe me nevojë emergjente për asistim, bllokimin e decentralizimit të fondeve publike. Si shkak të nivelit të ulët të mbledhjes së të ardhurave ata përmendën korrupsionin dhe evazionin fiskal.

Disa deputetë ngritën problemin që duhen përmirësuar procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e Buxhetit faktik të Shtetit, për të shkuar drejt aktualitetit në këtë proces. Ata ngritën shqetësimin se projektligji "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit", i cili do të zëvendësojë ligjin ekzistues, po vonohet shumë.

Në përfundim, Kuvendi e miratoi projektligjin me shumicë votash.

2. Projektligji "Për produktet e ndërtimit", miratuar në seancë plenare më 7 tetor 2004
Projektligji synon disiplinimin e prodhimit dhe të përdorimit të produkteve të ndërtimit nga pikëpamja cilësore, kontrollin e hedhjes në treg të tyre dhe mbrojtjen e konsumatorit. Plotësimi i legjislacionit në këtë fushë është i domosdoshëm për të siguruar përafrimin e tij me legjislacionin e vendeve të BE-së, duke i krijuar hapësirë operatorëve ekonomikë vendas që të zbatojnë standardet europiane.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seance plenare u miratuan disa ndryshime të karakterit jothelbësor në formulimin e disa neneve të projektligjit, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tij.

KALENDAR I

2 JAVOR (1-12 NËNTOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

E Hënë, datë 1.11.2004, Ora 17.00

-Seancë Plenare -

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.
2. Interpelancë me Ministrin e Punës dhe Çështjeve Sociale, kërkuar nga deputetja Marjeta Pronjari.
3. Interpelancë me Ministrin e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, kërkuar nga deputeti Sokol Olldashi.

E Martë, datë 2.11.2004

E Mërkurë, datë 3.11.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e Menaxhimit të Burimeve Ujore".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

2. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Koncensionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Koncensionare "Tirana Airport Partners" sh.p.k., për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen

e Aeroportit Ndërkombëtar "NËNË TEREZA" Tiranë dhe për dhënien e disa stimujve kësaj shoqërie koncensionare".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Industrisë dhe Financës

3. P/Ligji "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për Asistencë të ndërsjellte Administrative në çështjet doganore".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

4. P/Ligji "Për privatizimin e banesave të ndërtuara dhe të blera me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore dhe të objekteve të tyre të kthyer në banesa" (paraqitur nga deputetët Ylli Bufi dhe Albert Çaçi).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Industrisë

5. P/Ligji "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

6. P/Ligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 9040, datë 10.4.2003 "Për deklarimin

dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" (paraqitur nga një grup deputetësh, si dhe p/ligji i paraqitur nga deputeti N. Alibali).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

7. P/Ligji "Për privatizimin e Aksioneve, pronë e shtetit shqiptar të Bankës Italo-Shqiptare".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

8. P/Ligji "Për privatizimin e Aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

9. P/Ligji "Mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues Konsultativ në luftën kundër gjakmarrjes" (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Rendit

-Komisioni i të Drejtave të Njeriut

10. P/Ligji "Për luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes" (paraqitur nga deputeti A. Çako).

-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Rendit

(Vijon në faqen 6)

KALENDAR I

2 JAVOR (1-12 NËNTOR 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 5)

-Komisioni i të Drejtave të Njeriut

11. P/Ligji "Për barnat dhe shërbimet farmaceutike".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Shëndetësisë

12. Shqyrtimi i propozimeve për anëtar të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave".

-Komisioni i Ligjeve

13. P/Ligji "Për dërgimin e kompanisë paqeruajtëse shqiptare në Bosnje-Hercegovinë për të marrë pjesë në operacionin "ALTHEA", të Bashkimit Europian".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Mbrojtjes

-Komisioni i Jashtëm

14. P/Ligji "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Punës dhe

Çështjeve Sociale

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

E Enjte, datë 4.11.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare -

1. P/Ligji "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen "Për Transportin Ndërkombëtar të rasti të udhëtarëve me autobus" (Marrëveshja Interbus).

2. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për pranimin e personave".

3. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme".

4. P/Ligji "Për miratimin e strategjisë së sigurisë në Republikën e Shqipërisë".

5. P/Ligji "Për Veterinarinë".

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve për anëtar të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

E Hënë, datë 8.11.2004, ora 17.00

-Seancë Plenare -

1. Interpelancë me Ministrin e Mbrojtjes, kërkuar nga deputeti Uran Metko.
2. Interpelancë me Ministrin e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, kërkuar nga deputeti Sali Shehu.
3. Raport i Komisionit të Mandateve dhe Rregullores së Kuvendit për Çështjen e Im-

unitetit të deputetit Nikollë Lesi.

E Martë, datë 9.11.2004

E Mërkurë, datë 10.11.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Industrisë

2. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8615, datë 1.6.2000 "Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Shëndetësisë

(e ka shqyrtuar)

3. P/Ligji "Mbi Dhomën e Mjekëve Veterinarë dhe profesionin e mjekut veterinar" (paraqitur nga deputeti Neritan Alibali).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit

4. P/Ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8770, datë 19.4.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike".

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Rendit

5. P/Ligji "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë".

-Komisioni i Ligjeve

(Vijon në faqen 7)

Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 6)

- Komisioni i Industrisë**
6. P/Ligji “Akti i lirisë së Shtypit”.

-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Mjeteve të Informimit Publik

7. P/Ligji “Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit” (paraqitur nga deputetët N. Ndoka, A. Çako, I. Berzani).

-Komisioni i Ligjeve

8. P/Ligji “Për konfliktin e interesave”.

-Komisioni i Ligjeve
-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

E Enjte, datë 11.11.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare -

1. P/Ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe të marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Koorporatës Elektroenergjitike Shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin e prodhimit të energjisë termike në Vlorë”.
2. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e Pro-

gramit “Ndërtimi i Segmentit Rrugor Lushnje-Fier dhe supervizioni i punimeve për dy segmentet rrugore, Lushnje-Fier dhe Fier-Vlorë”.

3. P/Ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e Menaxhimit të Burimeve Ujore”.

4. P/Ligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Koncensionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Koncensionare “Tirana Airport Partners” sh.p.k., për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “NËNË TEREZA” Tiranë dhe për dhënien e disa stimujve kësaj shoqërie koncensionare”.

5. P/Ligji “Për privatizimin e Aksioneve, pronë e shtetit shqiptar të Bankës Italo-Shqiptare”.

6. P/Ligji “Për privatizimin e Aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë”.

7. P/Ligji “Për dërgimin e kompanisë paqeruajtëse shqiptare në Bosnje-Hercegovinë për të marrë pjesë në operacionin “ALTHEA”, të Bashkimit European”.

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj,
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”. Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, infomacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e infomacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare “QSP” në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

“Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për infomim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat. Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të saksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP.”

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org